



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:155888

Datë: 09.08.2024

Numri i dokumentit: 06037836

C.nr.3991/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, në çështjen kontestimore të paditësit S. (J.) F. nga Gjilani, lagjja “Dardania II”, Rr “ Pjetër Bogdani” nr.96, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Hajredin Leka, avokat nga Gjilani, rr “ Mulla Idrizi” nr.27, kundër të paditurve B. (H.) S. dhe Tefik Emërllahu që të dy nga fshati Uglarë, Komuna e Gjilanit, për shkak të ndarjes fizike të palujtshmërive, vlera e kontestit 3,100.00€, jashtë seancës gjyqësore, më datë 08.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.Konstatohet e tërhequr padia e paditësit S. (J.) F. nga Gjilani, e ushtruar kundër të paditurve B. (H.) S. dhe T. E., që të dy nga fsh.Uglarë, Komuna e Gjilanit, për kthimin e paluajtshmërisë, në vlerë të kontestit 3100.00€.

II.Shfuqizohet masa e përkohshme e sigurimit të kërkesëpadisë, e caktuar me Aktvendimin C.nr. 3991/24, i datës 04.06.2024.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi S. (J.) F. nga Gjilani, në këtë gjykata ka ushtruar padi kundër të paditurve B. S. dhe T. E., për kthimin e paluajtshmërisë, vlera e kontestit 3,100.00€.

Paditësi S. (J.) F., Komuna e Gjilanit, përmes përfaqësuesit të tij në këtë gjykatë, më dt. 06.08.2024, ka ushtruar parashtesë me kërkesë për tërheqjen e padisë ndaj të paditurve B. S. dhe T. E., për shkak se palët kanë arritur ujdj jashtëgjyqësore

Andaj, gjykata, duke u bazuar në nenin 261.1 të LPK-së, ku shprehimisht është përcaktuar se “*Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi*”, ka konstatuar tërheqjen e padisë, si dhe neni 309.1 të LPK-ës e cila përcakton se “*Masa e sigurimit e caktuar me vendim të gjykatës mbetet në fuqi deri sa mos të jepet vendim tjetër mbi masën e sigurimit*”, vendosi për shfuqizimin e masës së përkohshme të sigurimit, e caktuar me Aktvendimin C.nr. 3991/2014, i datës 04.06.2024, e ka shfuqizuar masën e përkohshme të sigurimit të kërkesëpadisë, e caktuar me aktvendimin C.nr.3991/24 të datës 04.06.2024, meqenëse paditësi e ka tërhequr padinë, e cila përmban kërkesën kryesore, nuk ekziston nevoja as për sigurimin e asaj kërkesë.

Numri i lëndës: 2024:155888
Datë: 09.08.2024
Numri i dokumentit: 06037836

Nga të cekurat më lart e në bazë të nenit 261.1 dhe 452.4 dhe nenit 309.1 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:155888, 09.08.2024

Gjyqtari
Berat Spahiu

Udhëzim mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.